



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**

Nr. 066 / 24  
Data. 29.01.24

Prishtinë, 29 janar 2024  
Kodi i ZRRE-së: V\_1833\_2024

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

**Duke u bazuar në:**

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenit 15 paragrafi 1 pika 1.2 dhe paragrafi 7 nënpar. 7.2, Nenin 25 dhe Nenit 26, paragrafit 1, nënparagrafin 1.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr. 25/ 14 Korrik 2016, Prishtinë));
- Dispozitat e Nenit 22 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Nr. 05/L-085 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr. 26/ 21 Korrik 2016, Prishtinë);
- Dispozitat e Nenit 5 të Rregullës Nr. 04/2020 për Përcaktimin e Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) për Kryerjen e Aktiviteteve të Ndërlidhura me Bashkimin e Tregut dhe Operimin e Tregut të Bashkuar;
- Dispozitat e Nenit 5 të Marrëveshjes Kornizë mbi Bashkimin e Tregjeve të Energjisë Elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës;
- Dispozitat e Nenit K.1.3.1 të Rregullave të ALPEX – Kushtet e Përgjithshme;
- Vendimin V\_1332\_2020 të datës 10.12.2020 për Aprovim në Parim të kërkesës së OT/KOSTT SH.A për transferim e disa të drejtave dhe përgjegjësi, që kanë të bëjnë me organizimin dhe tregtimin e energjisë elektrike një ditë para dhe brenda ditës, tek Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike (ALPEX sh.a.);
- Vendimin V\_1637\_2022 të datës 27.12.2022 për aprovimin e transferimit të të drejtave dhe detyrimeve për organizimin e tregut një ditë para, tregut ndërditor dhe kalkulimet e barazimit përfundimtar nga tek (ALPEX sh.a);
- Vendimin V\_1638\_2022 të datës 27.12.2022 për aprovimin e rregullave dhe procedurave (kushtet e përgjithshme, përkufizimet, procedura e tregtimit si dhe procedura e klerimit dhe shlyerjes);
- Vendimin V\_1748\_2023 të datës 17 korrik 2023 për aprovimin e kërkesës së Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike – ALPEX SH.A., dhe përcaktimin si Operator i Emëruar i tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), për kryerjen e Aktiviteteve të ndërlidhura me bashkimin e tregut të një dite para dhe ndërditor dhe Operimin e Tregut të Bashkuar për territorin e Republikës së Kosovës;
- Vendimin V\_1768\_2023 të datës 21 shtator 2023 për aprovimin e produkteve dhe llojeve të urdhërporosive që do të tregtohen fillimisht në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike ALPEX SH.A.;



- Vendimin V\_1793\_2023 të datës 01 dhjetor 2023 për vërtetimin e plotësimit të pikës II. të dispozitivit të Vendimit V\_1748\_2023 i datës 17 korrik 2023 sipas kërkesave ligjore, për sa i përket rishikimit, ndryshimit dhe miratimit të programit të zhvillimit ekonomik 2023 nga organet drejtuese të ALPEX;
- Vendimin Nr. 05 të datës 25.01.2024 të Komitetit Drejtues për Qeverisjen e Bashkimit të tregjeve të Energjisë Elektrike ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës, të pranuar me datë 26.01.2024; dhe
- Kërkesën e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike – ALPEX SH.A.- Dega në Kosovë për Fillimin e tregtimit të tregut të Një Dite Para të ALPEX SH.A. për zonën e ofertimit të Republikës së Kosovës, Nr. 040/24 të datës 23.01.2024;

në seancën e mbajtur me datë 29 janar 2024, nxori këtë:

## V E N D I M

- I. **APROVOHET** - kërkesa e shoqërisë Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike ALPEX SH.A., për fillimin e tregtimit të Një Dite Para për Zonën Tregtare të Republikës së Kosovës, e cila do të përkohet me ditën e fillimit të bashkimit të tregjeve të energjisë elektrike midis Shqipërisë dhe Kosovës.
- II. **APROVOHET** - Njësia Kohore e Tregut që i përket orës 00:00-01:00, e datës 01.02.2024.
- III. **OBLIGOHET** - ALPEX, që ti ndërmarr të gjitha veprimet për zbatimin e këtij Vendimi.

## A r s y e t i m

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (në tekstin e mëtejshëm: ZRRE) me datë 23.01.2024 nga shoqëria Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike – ALPEX SH.A. ka pranuar Kërkesën për Fillimin e tregtimit të tregut të një dite para të ALPEX SH.A. për zonën e ofertimit të Republikës së Kosovës.
- o Shoqëria Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike – ALPEX SH.A., në kërkesën e saj ka theksuar se në kuadër të detyrimeve dhe angazhimeve të ndërmarrja nga marrëveshjet në mes të KOSTT SH.A. , dhe ALPEX për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, për organizimin e tregut të energjisë elektrike një ditë para, tregut njëditor dhe kalkulimet e barazimit përfundimtar sipas Vendimit V\_1637\_2022 të lëshuar nga ZRRE janë përmbushur edhe obligimet si në vijim:
- o Platforma e Tregtimit ETSS, Platforma e Klerimit dhe Menaxhimit të Riskut EMSC janë gati dhe funksionojnë në përputhje me të gjitha kërkesat e Rregullave të ALPEX, Procedurave, Vendimeve Teknike si dhe të Propozimeve të miratuara përmes vendimeve të ZRRE-së.
- o ALPEX ka miratuar dhe publikuar të gjitha Vendimet Teknike përkatëse të Tregtimit dhe Klerimit, si një proces në konsultim me palët e interesit.



- ALPEX ka përfunduar Marrëveshjet me Bankën për Shlyerje, që në këtë rast është përzgjedhur të jetë ProCredit Bank. ProCredit Bank ka bërë të gjitha testimet e nevojshme të sistemit të bankës në ndërlidhje me sistemin EMCS të ALPEX, gjë për të cilën është certifikuar, dhe të gjitha transaksionet e Bankës janë certifikuar.
- ALPEX ka përfunduar marrëveshjen tip për Anëtarët e Përgjithshëm të Klerimit dhe ka nënshkruar këtë marrëveshje me ProCredit Bank si Anëtarë i parë i Përgjithshëm i Klerimit. Gjithashtu, ALPEX është në bisedime të nënshkrimit të kësaj marrëveshje edhe me Bankat tjera.
- ALPEX – Dega në Kosovë ka anëtarësuar shoqëritë publike të sektorit të energjisë, të tilla si:
  - Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut KOSTT SH.A.,
  - Korporata Energjetike e Kosovës KEK SH.A.,
  - Ndërmarrja Hidroekonomia Iber –Lepenc SH.A., dhe
  - Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike („KESCO“ SH.A),
- Gjithashtu ka njoftuar se ALPEX – Dega në Kosovë është në proces të anëtarësimit edhe të disa shoqërive tregtare të furnizimit.
- ALPEX –përmes kërkesës ka njoftuar se ka kryer periudhën e parë të testimit mbi integrimin e sistemeve ndërmjet ALPEX – KOSTT-SEE CAO-OST gjatë periudhës Tetor 2023-Dhjetor 2023.
- ALPEX përmes kërkesës ka njoftuar se ka kryer me sukses deri më datë 03.01.2024, që ishte dita e fundit e tregtimit, të gjitha testimet në Platformën e Tregtimit, në të cilën janë akomoduar kërkesat për çmimet minimale dhe maksimale të Urdhërporosive për tregun e Ankandeve të një dite para në lidhje me simulimet përkatëse të tregtimit.
- ALPEX përmes kërkesës ka njoftuar se ka kryer me sukses deri më datë 03.01.2024 të gjitha testimet në Platformën e Tregtimit, klerimit dhe Menaxhimit të riskut me Anëtarin e Përgjithshëm të klerimit dhe Shlyerjes të tilla si: regjistrimin e Anëtarëve të Bursës në ETSS, regjistrimin e Anëtarëve të Përgjithshëm të Klerimit në EMCS, vendosjen e kufijve të kreditimit nga Anëtari i Përgjithshëm i Klerimit, vendosjen e ofertave nga Anëtarët e Bursës në sistemin ETSS sipas kufirit të kreditimit të vlefshëm, mbyllja e portës dhe nxjerrja e rezultateve, publikimin, dërgimin e rezultateve pranë KOSTT, dërgimin e rezultateve pranë çdo Anëtari të Bursës dhe Anëtarit të Përgjithshëm të Klerimit, dhe kryerjen e shlyerjeve të transaksioneve në mënyrë automatike nëpërmjet Bankës për Shlyerje.
- ALPEX përmes kërkesës ka njoftuar se s’ bashku me Operatorët e Sistemit të Transmisionit OST dhe KOSTT si dhe Bankat për shlyerje dhe ProCredit-it, kanë filluar prej datës 10.01.2024 Dry-Ran me anëtarët e bursës nga dy zonat e ofertimit. Ky proces ka vazhduar çdo ditë me vendosjen e ofertave nga pjesëmarrësit deri në orën 12:00 kur mbyllen portat e librave të urdhërporosive, llogaritjen e çmimeve, sasisë për çdo zonë ofertomi si dhe rrjedhjen e energjisë nga njëra zonë në tjetrën. Ndërkohë çdo ditë sipas afateve përkatëse janë kryer me sukses shlyerja e transaksioneve dhe Klerimi nga EMCS për dy zonat.



- ALPEX përmes kërkesës ka njoftuar se, në përputhje me Rregullat e ALPEX- Kushtet e Përgjithshme dhe procedurat, ka në gatishmëri faqen zyrtare të internetit në mënyrë që të mundësojë publikimin e të gjitha raporteve të parashikuara.
- ALPEX përmes kërkesës ka njoftuar se ka trajnuar dhe certifikuar Agjentët Tregtar të Certifikuar, si edhe Agjentët Klerues të Certifikuar.
- ALPEX përmes kërkesës ka njoftuar se ka në gatishmëri stafin e saj, profesionalisht të aftë dhe ka të garantuar mbështetjen e Ofertimit të Shërbimit, në mënyrë që fillimi i operimit të jetë sa më i sigurt.
- ALPEX përmes kërkesës ka njoftuar se, Platforma e Tregtimit, Klerimit dhe Menaxhimit të Riskut ka implementuar vetëm Tregun e një dite Para dhe Urdhërporositë e Thjeshta, siç është bërë e ditur nëpërmes Propozimeve teknike.
- ALPEX konsideron që nën kushtet e mësipërme që të gjitha kërkesat e nevojshme për fillimin e operimit të tregut Një Ditë para janë përmbushur dhe në përputhje me Par. K.1.3.1 të Rregullave të ALPEX – Kushtet e Përgjithshme, citur “ E para Njësi Kohore e tregut për qëllim të këtyre Rregullave të ALPEX do të fillojë në Kohën e Përcaktuar”, e cila kërkon miratimin përkatës të Zyrës së Rregullatorit për Energji për Tregun e Një Dite para për zonën e Ofertimit të Kosovës.
- Andaj, ALPEX ka kërkuar nga ZRRE miratimin e fillimit të tregtimit për zonën tregtare të Republikës së Kosovës, e cila do të përkohet me ditën e fillimit të Bashkimit të tregjeve të energjisë elektrike midis Shqipërisë dhe Kosovës, në përputhje me përcaktimet e Nenit 5 të Marrëveshjes Kornizë mbi bashkimin e tregjeve të Energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës, e nënshkruar nga: ERE, ZRRE, OST sh.a., dhe KOST SH.A., të datës 21.10.2021, dhe fillimi i ditës së tregtimit të jetë dita e përcaktuar nga Komiteti drejtues i përbërë nga OST-të, dhe NEMO ndërkohë e para Njësi Kohore e tregut të jetë ora 00:00-01:00.
- ZRRE me datë 26.01.2024 nga Komiteti Drejtues për Qeverisjen e Bashkimit të Tregjeve të Energjisë Elektrike ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës, ka pranuar Vendimin për caktimin e ditës së fillimit të bashkimit të tregjeve të Energjisë Elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës, me të cilën është vendosur fillimi i bashkimit të tregjeve të energjisë elektrike ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës që të jetë Njësi Kohore e Tregut të Një dite Para që i përket orës 00:00 të datës 01.02.2024 sipas Kohës Lokale.
- Sipas Vendimit të Komitetit Drejtues është vendosur që Vendimi në fjalë do të hyn në fuqi pasi që Zyra e Rregullatorit për Energji e Republikës së Kosovës të ketë konfirmuar me Vendimin përkatës hapjen e Tregut të Një Dite Para për Zonën e Ofertimit të Kosovës.
- ZRRE pas vlerësimit të kërkesës së Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike – ALPEX SH.A.- Dega në Kosovë për Fillimin e Tregtimit të Tregut të Një Dite Para të ALPEX SH.A. për zonën e ofertimit të Republikës së Kosovës, dhe Vendimit të Komitetit Drejtues për Qeverisjen e Bashkimit të Tregjeve të Energjisë Elektrike ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës, ka vlerësuar se janë plotësuar kërkesat ligjore dhe ato proceduralo-administrative, prandaj, është propozuar që pas shqyrtimit dhe vlerësimit nga Bordi i ZRRE, të vendoset që të aprovohet kërkesa.



- Bordi i ZRRE-së, pas analizimit dhe vlerësimit e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike – ALPEX SH.A.- Dega në Kosovë për Fillimin e tregtimit të Tregut të Një Dite Para të ALPEX SH.A. për zonën e ofertimit të Republikës së Kosovës, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

IV. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodh e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, Anëtare

Gani Buçaj, Anëtar

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- Palës,
- ALPEX,
- KOSTT sh.a, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.